

JEHONA E TRAGJEDIVE TË HAXHIADEMIT PËRMES DISA KRITIKËVE TË KOHËS (VITET '30 -'40)

Gjatë një vëzhgimi të librave të shkollës së mesme, në një tekst të letërsisë të klasës së 10-të, më bëri përshtypje përfshirja e një shkrimtari si Et'hem Haxhiademi, që për ne të shkolluarit në kohën e diktaturës, si shumë autorë të tjerë të periudhës së Pavarësisë, ka qenë i përjashtuar për arsye jashtëletrare nga historiografia e artit shqiptar të fjalës.¹ Në programin e letërsisë së klasës së 10-të, tema për të vinte menjëherë pas klasicistëve të dramës franceze, si për të treguar ndikimin që tragjeditë e Haxhiademit kishin nga parimet klasike të letërsisë europiane. Në këtë tekst shkollor tema dukej e strukturuar dhe vepra e autorit paraqitej e zbërthyer mirë, qoftë nga pikëpamja historike, qoftë nga pikëpamja e analizës së tekstit, aq sa të krijonte përshtypjen se mendimet fshihnin sekretin e nyjetimit të gjatë interpretativ të këtij autori. Kur teksti i një autori klasik përfundon në tekstin shkollor, fjalitë duken sikur stereotipizohen, merren si aksioma dhe nuk të lënë shumë shpresën e një rigjallërimi të fjalës së shkruar letrare.

Ideja interesante e Antoinë Compagnon në librin e tij “Demoni i teorisë - Letërsia dhe kuptimi i zakonshëm”, ku pohohet se “klasike është ajo që studiohet në klasë”, më ndriçoi mbase për t'i bërë një rifreskim tekstit të Et'hem Haxhiademit, përmes një vëzhgimi historik për interpretimin kritik të letërsisë që ai prodhoi. Nëse kritika letrare është në thellësi të saj një refleksion mbi letërsinë, do të ishte diçka jo e natyrshme, që ajo të mos reflektonte edhe ndaj vetvetes. Dhe në fakt kjo ndodh shumë shpesh. Ndërsa e lexojmë një tekst apo një vepër letrare, shfaqen te ne disa sjellje

1 Shih: “Sipas skemës së përdorur në Bashkimin Sovjetik shkrimtarët klasifikohen në tri grupe të mëdha: revolucionarë, të lëkundur dhe kundërrivolucionarë. Për periudhat më të hershme përdoreshin etiketime më të shumëllojshme: demokratë, reaksionarë etj. Sipas kësaj skeme, Fishta, Koliqi, Haxhiademi, Skiroi, V. Prenushi u shpallën për arsye politike dhe jo letrare, fashistë, zogistë etj. Kurse Kuteli, Poradeci etj., hyjnë tek “të lëkundurit” tek000 kontradiktorët. [...] Në tekstet shkollore, Fishta, Konica, Koliqi futeshin në bllok në grupin e shkrimtarëve reaksionarë, kurse Haxhiademi nuk është përmendur fare ose rrallë. Vepra e tij, duke mos pasur që në kohën e vet laudinë e treshe sipërpërmendur mund të kalohej edhe në heshtje dhe kështu u mbështoll me mjegullnajën e harresës”. Matraxhiu, Bardhyl. “Kritikë e tragjedisë dhe tragjedi e kritikës”, Revista “Nëntori”, Nr. 7, Tiranë, 1991, f. 93-116.

të tipit kritik, që i përshtaten konsideratave të niveleve të ndryshme dhe vlerësimeve të niveleve të ndryshme. Për të ditur mirë se çfarë po bëjmë, duhet që të mos e paraqesim asgjë si të mirëqenë, por të nisemi me këmbë të mbarë dhe nga një pikëvështrim profesional.

Kështu, brenda këtij shkrimi, do të vëmë në përballje kritikë të ndryshëm të viteve '30-'40 dhe do të vështrojmë se si një qasje e caktuar kritike kërkon të përballlet me veprën e freskët letrare të Haxhiademit në kushtet e një prodhimi të zbehtë letrar dramatik.

Çfarë kriteresh qas kritika e kohës? Çfarë koherence ka mes hapave të ndryshme dhe niveleve të ndryshme të qasjes? Nga cila bazë teorike merr shkas? Do të zbresim tek parimet dhe do të shohim se mbi çfarë bazash ideologjike formohen hipotezat kritike, duke nxjerrë në dritë procedurat dhe rezultatet e ndryshme, si dhe nuk do të harrojmë të marrim në konsideratë tendencat letrare dhe përshtatjen ndaj tyre të tendencave kritike. Siç do të shohim, disa nga kritikët ishin edhe shkrimtarë, ndaj kishin një pikëvështrim mbi letërsinë e botuar tashmë, dhe atë që s'ishte prodhuar akoma.

Duket që kritika e kohës është vendosur në pozicionin tipik platonik, ku kritiku mjaftohet me kalimin e veprave dhe rileximin e tyre. Sipas këtij pikëvështrimi, janë gjithmonë veprat më të mira ato që mbijetojnë.

Po kështu, i njohur duket edhe pozicioni aristotelian, vlerësimi i veprës letrare. Kritiku bëhet gjykatës i mbijetesës, ose jo, të veprës letrare, duke ia besuar atë traditës, vetëm pasi t'ia ketë nënshtruar një gjykimi, që shpjegon ndërtimin dhe argumenton arsyet përse ajo duhet të trashëgohet.

Mes këtyre dy pozicioneve e shoh qëndrimin rreth njërës prej veprave më të diskutuara të Et'hem Haxhiademit, tragjedisë "Skënderbeu".

Në veprën e rëndësishme të Ibrahim Rugovës "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983" në çështjen që i kushtohet konsolidimit të kritikës në periudhën e forcimit të shtetit shqiptar në vitet '20-'30, studiuesi ndër të tjera ndalet te vlerësimi që i bëhej nga kritika disa kritereve jashtëletrare, ndër të cilat më kryesori:

*"Problemi i konceptit për shqiptarinë dhe shqiptarizmin, si vlerë kombëtare, u bë kriter vlerësimi për veprat letrare. [...] Duke u nisur nga ky kriter kombëtar, shtrohej edhe problemi i "shkrimtarit më shqiptar", e në bazë të kësaj edhe të "shkrimtarit më të madh". Kështu shkrimtarët, rreth të cilëve u shkruan më shumë kritika dhe herë - herë u ngritën polemika, ishin Naimi, Fishta, Lasgushi"*².

2 Rugova, Ibrahim. "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983". Shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë, 2005, f. 528, f.114-115.

Duhet shtuar se një tjetër autor rreth të cilit u ngritën polemika ishte edhe tragjediografi Et'hem Haxhiademi, i cili ishte bërë i njohur në këto vite për disa tragjedi që i botoi brenda një kohe relativisht të shkurtër, si: “Akili”, “Aleksandri”, “Ulisi” (të gjitha në vitin 1931), “Pirrua” (1934), “Skënderbeu” (1935), “Diomedi” (1936) dhe “Abeli” (1939). Frymëzimi tematik që këto vepra kishin nga mitologjia apo historia e lashtësisë dhe e mesjetës, nuk mund të mos vërehej nga kritika e kohës, ajo e viteve ‘30-‘40. Gjithashtu, u dallua nga kjo kritikë ndikimi që kishte autori nga poetika dhe estetika klasiciste. Ndërtimi i subjekteve dhe i karaktereve i përngjan atyre të klasikëve të mëdhenj të dramaturgjisë botërore, prej të cilëve Haxhiademi ishte mjaft i ndikuar, duke ruajtur deri në bindje parimin e njësisë të vendit, të kohës dhe të veprimit, si dhe në numrin e pakët të personazheve. Dukej se autori e kishte shumë për zemër pasurimin e sistemit letrar shqiptar me llojin letrar të tragjedisë, edhe pse në sistemin letrar evropian shkrimi i këtyre lloj tragjedish ishte një fazë e kapërcyer me kohë. Duke ndjekur këtë prodhim sa të freskët, aq edhe tradicional, kritika letrare e kohës do të vendosej në ndonjë rast edhe në skaje pro, apo kundër haxhiademizmës. Pa dashur të zmadhojmë rrethanën, na ndërmendet një ese e Kadarese “Eskili ky humbës i madh”, ku thuhet se Eskili nuk kishte asnjë libër në bibliotekën e tij, por krijoi tragjedinë. Për ta ngjyruar pak mendimin, duket se Haxhiademi i ngjan paksa babait të tragjedisë, përsa i përket sistemit tonë letrar, por ai vjen si një autor shumë i lexuar në lëmin e dramatikës dhe këtë kulturë të gjerë e shpall me veprën e tij.

Ajo që nxitu më shumë dialog në shtypin e kohës ishte vepra e tij “Skënderbeu”. Në përkrahje të kësaj vepre u rreshtuan: Vangjo Nirvana (Vangjel Koça), Branko Merxhani, Aleksandër Xhuvani, Elvira Tarro, Jup Kastrati etj.

Ndërsa në krahun e polemistit për këtë vepër qëndron Stefan Shundi (me pseudonimin Gjergj Kuka) e më pak Behar Shtylla (apo Bardhi Shtylla).

Stefan Shundi i diplomuar në Torino shkruante herë pas here në revista dhe gazeta të kohës. Rugova vëren: “

Mund të themi në bazë të këtyre shkrimeve, se Shundi gjykonte me ngut dhe nuk distancohej nga përkatësia regionale e pikëpamjeve për letërsinë”.³

Më tej, Rugova vëren se Shundi e mohonte në tërësi “Skënderbeun” e Haxhiademit.

3 Rugova, Ibrahim. “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”. Shtëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2005, f. 528, f.169.

Duket që kritikën e tij për veprën, Shundi nuk e ka me aq ngut, pasi përqendrohet mirë në elementet e formës dhe të përmbajtjes së veprës. Dy janë artikujt polemikë të Stefan Shundit (Gjergj Kuka) që debatojnë për “Skënderbeun” e Haxhiademit. I pari titullohet “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”, i cili publikohet në tri numra të gazetës “Arbënia”.⁴ Në fakt, në këtë shkrim shprehet edhe një lloj vlerësimi për krijimtarinë në përgjithësi të Haxhiademit.

*“Shkrimtarë të temperamentit të Haxhiademit s’kan nevojë për lavdatat tona veresie, mbasi e kanë fitue me mundime të vazhdueshme vendin e tyre në literaturën shqiptare”.*⁵

Pasi bën një paraqitje të karaktereve dhe të akteve të veprës “Skënderbeu”, duke i shtjelluar ato, Shundi jep për lexuesin modelin e tragjedisë klasike.⁶ Duke vijuar, ai vëren se tragjedia “Skënderbeu”, e cila u vu në skenën shqiptare, nuk e arriti suksesin e duhur, sepse ka veprim dhe karaktere të zbehta

*“... në mos fare të ftofta dhe sepse tanë veprës i mungon klima e përshtatshme për drama këso lloji”.*⁷

Zgjedhja si temë e tradhtisë së Moisi Golemit dhe trajtimi i kësaj figure në tragjedi, Shundit i duket qesharake. Sipas kritikut, autori nuk bazohet shumë në histori për të krijuar karaktere të tilla.⁸ Më pas, kritika shtohet rreth karaktereve të tjera të tragjedisë që zhgënjëjnë imagjinaren historike

4 Kuka, Gjergj. “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”. Gazeta “Arbënia”, 1-5-6 gusht 1936.

5 Kuka, Gjergj. “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”. Gazeta “Arbënia”, 1-5-6 gusht 1936.

6 Shih: “Veprimi i një tragjedie klasike zhvillohet në pesë akte duke u tregue në të parin prej tyre punët e maparshme të protagonistëve; në të dytin kundërshtimi i karaktereve dhe fillimi i grindjes së tyre; në të tretin acarimi i fjalëve në pikën ma të naltë. Në të katërtin akt këthehet veprimi, ndërrohet fati i ngjarjeve në mënyrë që të kuptohet afrimi i momentit tragjik dhe në aktin e pestë bahet zgjidhja e veprimit, realizohet momenti tragjik...”. Kuka, Gjergj. “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”. Gazeta “Arbënia”, 1-5-6 gusht 1936.

7 Kuka, Gjergj. “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”. Gazeta “Arbënia”, 1-5-6 gusht 1936.

8 Shih: “...A mund të besohet se shqiponjat, qi përballen ato kohë orë e çast me vdekjen, të kenë genë aq të vegjël sa të mendojshin se në shtëpi i priste një grue e do fëmij dhe se u duhesh pra ta ruenin mirë lekuren? Ç’do të bahesh prej fletave ma t’arta të heroizmit tonë kombëtar sikur na t’i përfytyrojshim në këtë mënyrë fatosat. Jo, jo, mik i dashtun Haxhiademi, shqiptari i kohës së Skënderbeut s’mendoj kurrë ke jeta, ke shtëpia, përpara nderit dhe flis për Atalhe, ose banë këto objekte tretije. Kambësorët dhe kalorësit u vërsulën me një hov të vetëm kundra vdekjes dhe u munduen me ia kalue shoqi-shoqit në dhuratën e jetës. Smund të pille pra kuklla koha e artë e historis sonë. Skënderbeu, Moisi Golemi e shokë janë krenët tonë të soçëm, janë prijat tonë të ardhshëm dhe na presin qi prej pendës të një shkrimtari shqiptar ata të na përshkruhen në mos edhe ma të naltë sesa genë në realitet, të paktën në vlerat e tyre historike, na duhet t’i ndigjojimë në guj veprat dhe burrëritë e paudekshme t’atyne fatosave”. Kuka, Gjergj. “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”, Gazeta “Arbënia”, 1-5-6 gusht 1936.

9 Kuka, Gjergj. “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”. Gazeta “Arbënia”, 1-5-6 gusht 1936.

kolektive të lexuesit për to. Ai kritikon edhe vargun e autorit.

*“Haxhiademi mendon dhe ndinë prozë, pastaj e ven prozën në varg: kështu qi hartimet e tija gjoja poetike s’kanë asgja te re dhe origjinale, shpirti i tragjedisë s’ka asgja të vjetër. Për më përshkrue Skënderbeun s’ka të tjera fjalë përveç se: Fatosi jonë me fletë; Liruesi i krishtënit; Trimi ma i madh qi rron në botë...”*¹⁰

Po sipas tij, lënë për të dëshiruar karakteret e tjera të veprës, të cilat i konsideron pa imagjinatë dhe lodhëse. Edhe figura e Skënderbeut në tragjedi nuk respekton imagjinaren historike kolektive.¹¹ Të njëjtat vërejtje ka edhe për Kont Uranin, Hamza Kastriotin, Donikën, Zanfinën, që kanë të njëjtën ftohtësi. Duke përfunduar Shundi thekson se autori kishte në dorë një subjekt të fortë që mund të çonte drejt suksesit.¹²

Në shkrimin “A propos të një artikulli mbi Et’hem Haxhiademin” të botuar te gazeta “Drita” e datës 15 prill 1937, Gjergj Kuka (Stefan Shundi) replikon me Vangjo Nirvanën (Vangjel Koçën) konkretisht me artikullin e tij të fundit me titull “Viti mendor 1936” e botuar në numrat 4,5,6 të revistës “Përpjekja shqiptare”. Vangjo Nirvana shkruante:

*“Lëvizje mendore ose më mirë lëvizje librare ka në Shqipëri edhe sa vete e po shtohet. Po kjo lëvizje librare, me fare pak përjashtime që hyjnë në kategorinë e lëvizjes mendore, përbën një “zhavore” për të vajtuar. [...] Et’hem Haxhiademi me “Skënderbeun” hyri në histori, po me “Diomedin” u kthye prapë në mythologji. Me Skënderbeun preku një çast dramatik të jetës së heroit tonë kombëtare...”*¹³

Në të gjithë këtë artikull, autori ndalet te vlera e Haxhiademit dhe te sulmet kritike që i bëhen për zgjedhjen tematike duke u zhytur në mitologji, sepse këto tema nuk i kishte zgjedhur njeri më parë.

Replika e Shundit në përgjigje të këtij artikulli është e copëzuar në çështje dhe i kthehet “Skënderbeut” të Et’hem Haxhiademit duke vënë

10 Kuka, Gjergj. “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”. Gazeta “Arbënia”, 1-5-6 gusht 1936.

11 “Heroi i tan një shekulli dhe shyllë krenie, asht paraqit këtu vorfnisht si ndën hije, si një trup pa frymë, si një shpirt pa atë zjarr pushtues qi ngushllon e gasmon zemrat tonë”. Kuka, Gjergj. “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”. Gazeta “Arbënia”, 1-5-6 gusht 1936.

12 “Haxhiademi veç s’e ka thanë ende fjalën e vet të fundit; [...] aj asht ende një tragjediograf i ri qi provon zhgjetat për me gjetun boshitn e qindrueshëm rreth të cilit të sillet. Këtë herë provoi dishka të re dhe mungoi. Na shumë të jemi me zotninë e tij të gjanë, sepse ia çmojmë pëndën; aj asht një artist dhe do ta kuptojë qëllimin tonë dhe s’kemi dyshim se do të na çmojë”. Kuka, Gjergj. “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”. Gazeta “Arbënia”, 1-5-6 gusht 1936.

13 Nirvana, Vangjo (Vangjel Koça). “Viti mendor 1936”. Revista “Përpjekja shqiptare”, nr. 4,5,6, Tiranë, 1937.

në dyshim konsideratat pozitive të Vangjo Nirvanës.¹⁴ Shundi edhe në këtë shkrim mbështet idenë se “Skënderbeu” është një vepër që nuk e ka “kollaudimin e historisë”. Pastaj i referohet objektivitetit të ndjenjës që duhet të paraqitet në poezi, duke na dëshmuar kështu që ka një njohje të mirë për kritikën e kuptimit. Tek çështja “Edhe sendet më të vogla mund të bëhen subjekte arti”, Shundi dëshmon përgatitjen e tij të mirë në lëmin e estetikës, kur vlerëson gjenialitetin dhe originalitetin e artistit në kapjen dhe gjetjen e detajeve artistike. Ndërsa tek çështja “Ç’është arti i vërtetë” Shundi pohon sendërtimin e artit të fjalës dhe vlerën tingullore të shprehësisë së saj, si dhe gjallërimin që merr gjuha e veprës, shembuj këto të njohjes së mirë teorike që ai ka për letërsinë.¹⁵ Ndërsa në çështjen e fundit të artikullit “Cili është kritiku i vërtetë”, Shundi pohon se duhet bisturi për analizën e veprës dhe për ta bindur lexuesin.¹⁶

Në polemikë me Stefan Shundin do të futej edhe vetë autori Et’hem Haxhiademi përmes shkrimit “Një polemikë letrare. Rreth tragjedisë “Skënderbeu”.¹⁷

Duke evokuar shembullin e Aleksandër Xhuvanit, autori mendon se heshtja nuk është gjë e mirë dhe i përgjigjet kritikës së Stefan Shundit (Gjergj Kuka) për kritikën e bërë të gazeta “Arbënia” në numrat e datave 1,5,6 gusht 1936 dhe të 15 prillit 1937 të gazeta “Drita”. Haxhiademi

14 Shih: “*Tue lanë mënjane thashethemet rrugash, më duket se mbi Skënderbeun e Haxhiademit vetëm i nënshkruemi s’u bashkova me osanat e z. Vangjo Nirvana, Aleksandër Xhuvanit recensitorit të “Illyris”. Uroj që të jem klasifikuem në atë përjashtim që gjykon me besim të mirë, sepse sikur të rëndobesha ndër antihaxhidemistë, do të më vinte më të vërtetë keq*”. “*Çdo poezi duhet të jetë reprezentative, domethanë të api e të shprehë shpirtin njerëzor dhe jo egon e vjershëtorit.[...] Në “Skënderbeun” vuejjet s’qenë simpatike e prandaj poezia duhet të jetë e vogël dhe e sëmure*”. Kuka, Gjergj. “A propos të një artikulli mbi Et’hem Haxhiademin”. Gazeta “Drita” 15 prill 1937.

15 Shih: “*Në rasën tonë, jo subjekti i mungoi Haxhiademit, por duhu (duku), frymëzimi, e për ta provue këtë, mund të tregojmë se aj falsoi madhësitinë e historisë së Skënderbeut e borri edhe qëllimin e veprës. Instiktet e popullit nuk gënjehen kollaj, për këto Gjergji Kastrioti, Moisi Golemi është Shqipëria e fortë, krenare dhe e bukur. Le të më ndiejë zoti Vangjo Nirvana në po guxoj t’i them me anë të këtyre radhëve, se, duke i gjykuar kështu siç ban zotinja e tij veprën letrare profani, do të bëqesh në një udhë të gabueme e studiuesi do të thonte se kritika e jonë është tjetër veçse la puissance des impuissants (fuqia e të pafuqishmëve, përkthim i imi)*”. Kuka, Gjergj. “A propos të një artikulli mbi Et’hem Haxhiademin”. Gazeta “Drita” 15 prill 1937.

16 “*Kritiku i vërtetë duhet të ketë formue një ndërgegjeje të plotë të botës që shqyrton, e mandej të përcaktojë, tue i dhanë vlefë të vendin që meriton. Kjo domethanë me të vërtetë me e gjykuar ose me kritikuar: nga ana tjetër s’është gjithmonë e domosdoshme që të vijë para gjykimit përshtypja ose vegimi, mba një herë mjafton edhe një nënkuptim; duhet patjetër veç që kritiku, para se të gjykojë, të ketë një përshtypje të kjaritë e një vetëdije të përsosun të përmbajtjes së veprës, edhe kur nuk e shpreh këtë*”. Kuka, Gjergj. “A propos të një artikulli mbi Et’hem Haxhiademin”. Gazeta “Drita” 15 prill 1937.

17 Haxhiademi, Et’hem: “Një polemikë letrare. Rreth tragjedisë “Skënderbeu”. Revista “Përpjekja shqiptare”, nr. 8, Tiranë, maj, 1937, f.121-126.

citon edhe pjesë të debatit të zhvilluar më parë mes Stefan Shundit e Vangjo Nirvanës, sepse ky i fundit në revistën “Përpijekja shqiptare” e ka vlerësuar Haxhiademin dhe i ka konsideruar kundërshtarët e veprës së tij si “antihaxhidemistë”. Këtë tragjediografi e konsideron gjykim tendencioz. Ai vëren se është lavdëruar në fillim të artikullit, pastaj është kritikuar për karaktere të zbehta te vepra “Skënderbeu”. Sipas tyre, Skënderbeu nuk qenka heroi ynë legjendar që tregon historia, Hamzai nuk paska guximin të nxjerrë shpatën, Donika është e thatë, Zanfina e mërzitshme si dhe proteston për Moisi Golemin, që i bie në gjunjë Skënderbeut.

Sipas Haxhiademit skena është historike dhe mbështetet te Barleti, tivarasi. Ai përgjigjet se nuk është kusht i domosdoshëm në dramaturgji të jesh medoemos besnik i përpiktë i historisë. Vepra e artit është trillim poetik e jo historik. Nga leximet e autorëve të famshëm ai vlerëson

“...se personat e dramavet historike duhet të jenë medoemoos të pikëpërpiktë, por sa të jetë e mundun, me ata të historisë”¹⁸

Pastaj Haxhiademi merr shembuj nga fusha e dramaturgjisë, duke vërejtur lëvizshmërinë e karaktereve të marra nga historia apo mitologjia te dramaturgë të ndryshëm të antikitetit dhe të mëvonshëm, që nga Eskili, Sofokliu, Rasini, Volteri, Bernard Shou. Autori shtron pyetjen:

“Nuk besoj të mos i kesh këndue me që ke hapun fushatën e një kritiku letrar.[...] Secili i ka piktuaruar personat me nga një karakter që u ka pjellë fantazija”.

Këtu ai iu referohet karaktereve sipas klasicizmit, si dhe skemës piramidale të tragjedisë. Më tej ndalet te kritika që i bën Stefan Shundi (Gjergj Kuka) gjuhës së tragjedianit

“...edhe ata që s’kanë qenë të kënaqun me veprat e mija nuk e kanë mohue gjuhën e bukur dhe poezinë që kanë pa të derdhun në to.[...] Por kur zoti Gjergj Kuka therret e bërtet herë në një gazetë e herë në një tjetër, herë në burg e herë jashtë, Skënderbeu shfaqet në të katër anët e Shqipnis dhe krijon entuziazmën e publikut”¹⁹

Ndër përkrahësit e Haxhiademit ishte Aleksandër Xhuvani, i cili botoi një recension në dy numra të gazetës “Illyria” më 4 dhe 11 janar 1936 me

18 Haxhiademi, Etëhem. “Një polemikë letrare. Rreth tragjedisë “Skënderbeu”. Revista “Përpijekja shqiptare”, nr. 8, Tiranë, maj, 1937, f.121-126.

19 Haxhiademi, Etëhem. “Një polemikë letrare. Rreth tragjedisë “Skënderbeu”. Revista “Përpijekja shqiptare”, nr. 8, Tiranë, maj, 1937, f.121-126.

titullin “Nji tragjedi e re shqipe”. Për “Skënderbeun” e Et’hem Haxhiademit, Xhuvani bën një shkrim pozitivist, përmes të cilit në fillim jep disa të dhëna për veprat e tjera të autorit dhe preferencën e tij për frymën klasike të tragjedisë. Më pas ndalet te fabula e tragjedisë dhe tregon ndodhitë e pesë akteve të saj, duke përshtatur tregimin e tij sipas trekëndëshit strukturor të dramës klasike. Më pas, vijon me komentin e të gjitha karaktereve të tjera të tragjedisë, që i konsideron të arrirë, duke e ilustruar vlerësimin e tij me copëza të dialogut.²⁰ Skënderbeu, sipas Xhuvanit, shfaqet si hero i matur, i urtë, i çiltër, i durueshëm, por edhe mëshirëplotë e shpirtmadh, sepse e fal Moisiun edhe pse të tjerët e këshillojnë ta dënojnë.²¹

Xhuvani vlerëson vargun e tragjedisë

*“...një pentapodi jambike, rrjeth bukur e me harmoni dhe gjuha
është e rrjedhshme dhe e kuptueshme”.*²²

Recenca përfundon me idenë kryesore që ka përcaktuar Xhuvani “naltësimi e idealizmi i personit të Skënderbeut”.²³

Në numrin 4 të tetorit 1941 të revistës “Shkëndija” botohet një shkrim i gjatë më realist dhe objektiv i Bardhi Shtyllës (Behar Shtylla). Artikulli i titulluar “Tragjedit e Haxhiademit” bën një panoramë të kontributit të këtij shkrimtari në prodhimin letrar. Kemi një pamje përmbajtësore të të gjitha tragjeditë të shkruara nga autori deri në atë moment, si dhe një vlerësim pozitiv për stilin e tij. Analiza është e natyrës komentare. Tek-tuk paraqitet edhe ndonjë dobësi për vargun dhe gjuhën e tragjediografit.²⁴²⁵ Bardhi Shtylla është i pari që e emërton “Skënderbeun” si tragjedi psikologjike.²⁶

20 “Në këtë tragjedi personat janë të nalta e të mëdhaja, sikur i ka hije një tragjedi klasike: së parit figuron Skënderbeu, që është protagonist i tragjedisë...”. Xhuvani, Aleksandër. “Nji tragjedi e re shqipe”. Gazeta “Illyria”, 4 dhjetor 1936.

21 “Mojsiu i prekun thëllë në zemër për këtë shpirtmadhësi të Skënderbeut e cilëson me këto fjalë sublime: O mbret ndër lufta i tërbuem për gjaqel/Dhe më i shenjt’ se shenjtët në koh’ paqe”. Xhuvani, Aleksandër. “Nji tragjedi e re shqipe”. Gazeta “Illyria”, 4 dhjetor 1936.

22 Xhuvani, Aleksandër. “Nji tragjedi e re shqipe”. Gazeta “Illyria”, 11 dhjetor 1936.

23 Xhuvani, Aleksandër. “Nji tragjedi e re shqipe”. Gazeta “Illyria”, 11 dhjetor 1936.

24 “Nuk e di se gjer në çpikë mund t’i përshtatet tragjedis klasike njëmbëdhjetërokëshi që përdor Haxhiademi, por ashtu me rimë të varfër, me pak larmi në cezurat e me afshin e cekët poetik të vargjevet, është monoton, kurse dihet që ritmi lypset të pajtohet me kuptimin e ligjëratës”. Shtylla, Bardhi (Behar Shtylla). “Tragjedit e Haxhiademit”. Revista “Shkëndija” nr. 4, Tiranë, tetor 1941, f.127.

25 Tragjeditë e para të Haxhiademit i konsideron: “Kanë trajtë dhe tul peme, por u mungon ëmbëlsia vulltuozë e pemës së rritur kur kryhet ngjizja. Ato rrjedhin nga shartimi i shpirtit shqiptar, pa tradicion arti (sidomos teatroje), me formën e tragjedis klasike së cilës Haxhiademi do t’i afrohet mjaft në periudhën e dytë që fillon me “Pirron””. Shtylla, Bardhi (Behar Shtylla). “Tragjedit e Haxhiademit”. Revista “Shkëndija” nr. 4, Tiranë, tetor 1941.

26 “Në këtë tragjedi krejt psikologjike maturiteti artistik i autorit duket në skenat korneliane, në përpilimet e thella të karaktereve kryesore: Skënderbeu dhe Zanfina, karaktere të pakrahësueshëm për

Finalen e tragjedisë e konsideron të vakët dhe pa një përfundim logjik. E kritikon për dyfishimin e veprimit dramatik. Ai shprehet se duket që medoemos Haxhiademi kërkon gjak në tragjedinë e tij.²⁷

Mendimi për të qenë shterues në paraqitjen e thelbit të dialogut që zhvillohej në shtypin e kohës për tragjedinë “Skënderbeu” ishte pikënisje për këtë shkrim, megjithatë nuk është sjellë i plotë i gjithë korpusi i artikujve për të.

Vlerësime pozitive bënë në disa artikuj për krijimtarinë e Haxhiademit në përgjithësi, edhe Branko Merxhani²⁸, Jup Kastrati²⁹, Elvira Tarro³⁰. Ajo që ka rëndësi për ne dhe sistemin tonë dinamik letrar është pasqyrimi sa më objektiv i kritikës së kohës, pikërisht i asaj kritike që e kishte kaluar në sitën e saj këtë vepër dhe i kishte dhënë një interpretim të qenësishëm.

Siç vërehet nga paraqitja në këtë shkrim, kritikët e kohës (që koincidojnë edhe në një kohë lufte) ndeshen në betejën letrare në frontin e kritikës së modeleve dhe kritikës koment, dy anë këto që shpeshherë shkrihen mes tyre te të njëjtët autorë. Në përgjithësi ata riafirmojnë modelin horacian. Shkrimi në vargje, ekuilibri, mjeti i saktë, natyrshmëria dhe harmonia dalin në dritë si vlera të mirëkuptimit. Ata propagandojnë qartësinë, duke kërkuar nga teksti letrar “Skënderbeu” të komunikojë pa e lodhur lexuesin sipas vlerës së rrjedhshmërisë. Racionalizmi i propozuar nga ata është në koherencë më “Artin poetik” të Boileau -it, ku vepra e artit nuk paraqitet përmes konstruktit të tipit *vepra “duhet të jetë në vetvete”*, por duhet të jetë e miratuar nga qëndrimi i publikut. Duke shtruar si çështje problemin e publikut, se si ta mbajmë gjallë vëmendjen, tregohet që mirëkuptimi për

cilsi”. Shtylla, Bardhi (Behar Shtylla). “Tragjedit e Haxhiademit”. Revista “Shkëndija” nr. 4, Tiranë, tetor 1941, f.129.

- 27 “Në rast se Haxhiademi do gjak me çdo mënyrë në tragjedit e veta, haj me zhdukjen e Hamzajt, haj me kthimin e Moisiut – sikundër ngjet – Zanfina mund t’a vrasë veten. Por “nuk është e domosdoshme që, në një tragjedi, të rrjedhë gjak, të ketë të vdekur; mjafton që veprimi të jetë i lartë, vetët të jenë heroikë, epshet të nxitur e çdo send në të të jetë i veshur me atë trishtim madhështor që përbën krejtë endjen e tragjedis”. Dhe Racine që vetë shembull duke thurur tragjedinë e thjeshtë dhe klasike Bérénice rreth fjalëve: “Të dua, je perandor e po shkoj”, pa i shkukur as thikë, as shigjetë, pa derdhur pikë gjaku. Drami klasik lyp veprim të thjeshtë: *Denique sit quodvis simplex dumtaxat et unum*” (Arti poetik Horaci), përsërit Horaci pas Aristotelit. Por Haxhiademi ndoshta ka kërkuar ta paraqesë shpirtin e Skënderbeut si fuqi dhe mëshirë që përtërihet? E vërteta është që dramaticiteti thërrmohet në këtë veprim të dyfishtë dhe me përfundim centrifug”. Shtylla, Bardhi (Behar Shtylla). “Tragjedit e Haxhiademit”. Revista “Shkëndija” nr. 4, Tiranë, tetor 1941.
- 28 Merxhani, Branko. Etëhem Haxhiademi. “Diomed, tragjedi me pesë akte”:shtyp. Kristo Luarasi, Tiranë 1936, në “Përpjekja shqiptare”, 1937, nr.8, f. 121-126.
- 29 Kastrati, Jup. “Dramatika - Qysh xue fill dramatika jonë”. “Revista letrare”, Tiranë 15 korrik - 1 gusht 1944.
- 30 Tarro, Elvira. “Etëhem Haxhiademi”. Gazeta “Tomori i vogël”, nr. 6, Tiranë, 15 mars 1942.

vlerat artistike duhet fituar në terren.

Ana tjetër e mirë është forma koment që përdorën këta kritikë duke u vënë në shërbim të tekstit, duke punuar në kufijtë e tij dhe duke e bërë më të kuptueshëm, për ta afruar me lexuesin dhe për ta favorizuar atë. Komenti është një praktikë pluraliste, shënime nga burime të ndryshme, dhe mund të bashkëjetojë dhe të variojë në shumë drejtime të mundshme. Kritika e kohës është përpjekur t'i japë Haxhiademit një vend në historinë e letërsisë. Këtë e dëshmojnë edhe historitë e letërsive të botuara, por edhe artikujt e ndryshëm studimorë historiko-letrarë.

Përhapja e gazetave dhe e revistave me sfond kulturor dhe letrar në këto vite arriti të tërhiqte një rreth të gjerë komunikimi. Letërsia aty trajtohej në brendësi të çështjeve të zakoneve dhe të modës, përmes një toni rikrijues. Këta kritikë të gazetës punonin për të udhëhequr lexuesin drejt zgjedhjes së duhur në hapësirën e librit. Edhe kjo polemikë na tregon se është mirë që në periudhat e para letrare kemi figurën e kritikut që ndërvepron me tekstet, me një ndërhyrje të shpëputur në kohë, duke ndjekur të bërit e letërsisë në proces. Mënyra në të cilën ajo paraqitet është tashmë ajo e kritikës militante. Këta kritikë përfaqësonin tipin e kritikut që pretendon të ketë autoritetin e duhur, pasi jashtë përleshjes kërkohet një spektator asnjans.

Është koha që “Skënderbeut” të Haxhiademit t'i jepet edhe një vend në teatrin e sotëm, në mediumin e duhur, për të cilin tragjedia ka lindur.

Në vitet '90 ose në fillimin e tranzicionit, ky autor u rehabilitua aq mirë nga studimet e shumta bashkëkohore letrare, shpeshherë duke u konsideruar edhe modern³¹. Atëherë shtrohet pyetja: Pse të mos e shohim të aktualizuar edhe në teatër “Skënderbeun” e Haxhiademit, në mënyrë që lexuesi-spektator bashkëkohor të krijojë një ide për dialogun që kjo vepër prodhoi dikur në skenë dhe në kritikë.

Ja pse në mbyllje të këtij shkrimi mund të bashkëndajmë këtë citim të Vangjel Koçës:

“Historia na mëson se arti dramatik nuk lulëzon në epoka tranzitive, siç është epoka e sotme shqiptare.[...] Epokat tranzitive nuk e durojnë kritikën. [...] Librat e shtypur mund të kufizohen në pak duar. Por skena teatrore është një libër i gjallë që i flet tërë popullit. Perioda e sotme shqiptare mund të durojë vetëm vepra të

31 Shih: “I pajisur me kulturë të gjerë, E.Haxhiademi u bë një nga stilistët dhe udhëheqësit e dramës mitologjike e moderniste, duke risjellë me subjektet e moçme shtresime e ngjyresa të kohëve aktuale, me theksa mbi anët morale dhe ekzistenciale të njeriut”. Papagjoni, Josif. “Historia e teatrit shqiptar”, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2011, f. 54.

frymëzuar nga perioda e Rilindjes Kombëtare, ku mund të gjejë tema që të na thotë se sa të mbëdhenj ishin krijonjësit e Rilindjes sonë dhe se sa të vegjël jemi ne sot. Haxhiademi është për të vënë re dhe një vlerë morale e rrallë, cilësira këto që e bëjnë të përshtatshëm për degën që ai punon dhe në të cilën është sot punëtori më i mirë dhe më i çmuar.³²

Jemi në kohë për ta nxjerrë Haxhiademin “klasik”, qoftë edhe për pak orë nga “klasa”, e pse jo për ta çuar edhe në teatër, duke jetësuar kështu ndihmesën e tij në lëmin e dramaturgjisë. Si hap i parë për ta bërë këtë aktualizim, është të futemi në lëkurën e epokës kur shkroi dhe u shkrua për të.

Bibliografia

1. Bala, Muhamet. “A kemi një dram modern shqiptar?”. Revista “Kultura islame”, Tiranë, 1942, nr.5-6-7, Kallnuer-Shkurt, f.214-217.
2. Çaçë, Durim. “Diskursi i tragjikes në letërsinë shqipe”. Shtëpia botuese “OMBRA GVG”, Tiranë, 2017, f. 454.
3. Haxhiademi, Etëhem. “Një polemikë letrare. Rreth tragjedisë “Skënderbeu”. Revista “Përpjekja shqiptare”, nr. 8, Tiranë, maj, 1937.
4. Kastrati, Jup: “Dramatika -Qysh xue fill dramatika jonë”. “Revista letrare”, Tiranë 15 korrik - 1 gusht 1944.
5. Kuka, Gjergj. “A propos të një artikulli mbi Etëhem Haxhiademin”. Gazeta “Drita” 15 prill 1937.
6. Kuka, Gjergj: “Gjana qi mbesin dhe gjana qi vdesin”. Gazeta “Arbënija”, 1-5-6 gusht 1936.
7. Matraxhiu, Bardhyl. “Kritikë e tragjedisë dhe tragjedi e kritikës”. Revista “Nëntori”, Nr. 7, Tiranë, 1991, f. 93-116.
8. Nirvana, Vangjo (Vangjel Koça). “Abeli” dhe “Lyra” të Etëhem Haxhiademit. Gazeta “Tomori”, Tiranë, 1940, 24 mars.
9. Nirvana, Vangjo (Vangjel Koça). “Viti mendor 1936”. Revista “Përpjekja shqiptare”, nr. 4,5,6, Tiranë, 1937.
10. Papagjoni, Josif. “Historia e teatrit shqiptar”, Qendra e Studimeve

32 Nirvana, Vangjo (Vangjel Koça). “Viti mendor 1936”. Revista “Përpjekja shqiptare”, nr. 4,5,6, Tiranë, 1937, f. 201-204.

Albanologjike, Tiranë, 2011, f. 522.

11. Rugova, Ibrahim. “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”. Shtëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2005, f. 528.
12. Shtylla, Bardhi. “Tragjedít e Haxhiademit”. Revista “Shkëndija” nr. 4, Tiranë, tetor 1941.
13. Tarro, Elvira. “Etëhem Haxhiademi”. Gazeta “Tomori i vogël”, nr. 6, Tiranë, 15 mars 1942.
14. Xhuvani, Aleksandër. “Nji tragjedi e re shqipe”. Gazeta “Illyria”, 4-11 dhjetor 1936.